



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4685 Prot.

Roskovec, më 31, 07 2023

VENDIM

NR 68 .DATË 18.07 .2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES KËSHILLIT BASHKIAK  
PËR MUAJIN QERSHOR 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.06.2023, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Qershor 2023.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4211/1 Prot.

Roskovec, më 30.06.2023

Procesverbal Nr.9

*-I mbajtur sot, datë 29.06.2023, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së konstituimit të datës 14.06.2023.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Mbi miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Roskovec.
5. Për krijimin e Komisioneve të Përherëshme të Këshillit.
6. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2023.
7. Për caktimin e vendqëndrimit provizor të shitësve ambulant në qytetin e Roskovecit.
8. Për eliminimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimin e banesës me kosto të ulët (objekti social 6-katësh).
9. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2022.
10. Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2024-2026.
11. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
12. Raport i monitorimit për 4-mujorin e I viti 2023.
13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>10</sup>

Këshilltarët prezant: A.Plaka, E.Musko, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, A.Pelo, S.Bibo, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë : Rapi Hazizi dhe Viola Çepele.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Financës S.Çepele, Dr.Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit E.Hoxha, P/Shërbimit Social S.Saliaj, P/Dr.PZhT E.Hatia.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari i këshillit hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 19 këshilltarë. Para se të hedhi në votim rendin e ditës, Kryetari bën me dije se sot na ka ardhur një material shtesë nga administrata e bashkisë, të cilën duhet ta fusim në rendin e ditës. Materiali është : "Për miratim të përdorimit të fondit rezervë për vitin 2023". Dhurata-tani na ra në dorë ky material, duhet ta lexojmë. Jorgo-ne duhet të konsultohemi për këtë material. Nënkryetari M.Goga me ligj rendi i ditës bëhet 5 ditë para, por çdo material shtesë miratohet nga këshilli për tu futur

shtesë apo jo. Ky materjal ka të bëj me lyerjen e shkollave, është me tenderim dhe nuk kemi kohë që Shtatori të na gjejë me shkolla të lyera, për këtë arsye e sollëm sot. Leximi-mendoj ta hedhim në votim shtesën dhe rendin e ditës. Jorgo-hedhim në votim rendin e ditës pastaj shtesën. Kryetari e hedh në votim për ta shtuar projekt-vendimin në rendin e ditës dhe miratohet me 15 vota pro, 2 vota kundër E. Xhaxhaj, J. Begaj. Miratohet me shumicë votash për tu shtuar në rendin e ditës. Fredi-pika Nr.10 e rendit të ditës është voluminoze, dhe ne nuk patëm kohë ta studionim. Sugjeroj që ta shtyjmë për në mbledhjen tjetër pikën 10. Kryetari-shqetësimi juaj është i drejtë, por ky materjal kalon në 3 faza dhe nuk është projekti përfundimtar, do keni të drejtë për të bërë vërejtje dhe sugjerime gjatë kësaj kohe. Unë e kam parë seriozisht shqetësimin tuaj, por ky projekt ka një afat ligjor, dhe nuk është përfundimtar. Fredi-ne nuk jemi specialistë të fushës, e kalojmë muajin tjetër. Kryetari-të njëjtin materjal do e votojmë në këshill 3 herë, kjo është faza fillestare, në Shtator priten të gjitha vërejtjet, sugjerimet për ta përmirësuar, dhe në Dhjetor ky projekt merr formën përfundimtare, pra do keni gjithë kohën e nevojshme për ta parë.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Hidhet në votim rendi i ditës bashkë me shtesën e bërë si më sipër dhe miratohet me 11 vota pro, 6 vota kundër nga Bashkë Fitojmë. Miratohet me shumicë votash.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së konstituimit të datës 14.06.2023.

Sekretarja e Këshillit sqaron informacionin. Në mbledhjen e kaluar ju keni miratuar 4 vendime, 2 prej tyre ishin vendime normative të cilat i dërguam në Prefekturë për verifikim ligjor. Të 2 këto vendime janë miratuar nga Prefektura. Sekretarja u sqaron se vendimet ndahen në normative, kolektive dhe individuale. Në Prefekturë ven për verifikim vetëm aktet normative. Të gjitha vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar kanë hyrë në fuqi sipas ligjit.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Sekretarja sqaron se në bazë të rregullores së këshillit, procesverbali i mbajtur në mbledhje, duhet të miratohet në mbledhjen pasardhëse. Ky materjal ka të bëj me procesverbalin e mbajtur në mbledhjen e kaluar. Nuk ka diskutime. Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimit me 17 vota pro.

4. Mbi miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Roskovec.

Kryetari-në mbledhjen e konstituimit kishim dy mungesa z. Elmaz Çepele dhe znj. Pegiola Toro, të cilët do të marrin mandatin sot, dhe që janë prezent në mbledhje. Ngrihet komisioni i mandateve dhe bën verifikimin e mandatit të dy anëtarëve, dhe harton raportin e komisionit të mandateve për dy këshilltarët. Hidhet në votim raporti i komisionit të mandateve për dhënien e mandatit dy këshilltarëve: z. Elmaz Çepele nga Partia Socialiste dhe znj. Pegiola Toro nga Bashkë Fitojmë dhe miratohet unanimit me 17 vota pro. Kryetari lexon formulën e betimit dhe këshilltarët z. Elmaz dhe znj. Pegiola betohen. Nënshkruajnë formulën e betimit sipas ligjit. Kryetari dhe këshilltarët ju urojnë suksese këshilltarëve të mandatuara. Para se të kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, Ermira Buzi kërkon 5 minuta pushim. Këshilltarët bien dakort për 5 minuta pushim për grupin e PS. Pas pushimit, Kryetari i uron edhe njëherë anëtarët e rinj të dalin faqebardhë, dhe vazhdon me rendin e ditës.

5. Për krijimin e Komisioneve të Përherëshme të Këshillit.

Kryetari sqaron se ka dy lloje komisionesh, komisione të përkohëshme dhe komisione të përherëshme. Në këshillin tonë kemi 9 komisione të përherëshme, ku 5 komisione janë nga radhët e pozitës dhe 4 janë nga radhët e opozitës. Ne kemi bërë një projekt duke u bazuar edhe në arsimin e këshilltarëve. Dhurata-proponon që në komisionin Nr.3 Komisioni për Zhvillimin Urbanistik dhe

Ndërtimet të zëvendësohet Jorgo Begaj me Pegiola Toro.Për gjithë komisionet e tjera jemi dakort si grup.Sekretarja sqaron edhe njëherë propozimin e grupit Bashkë Fitojmë,ku në Komisionin për Zhvillimin Urbanistik dhe Ndërtimet Jorgo Begaj do të zëvendësohet me Pegiola Toro.Kryetari pyet nëse ka diskutime për komisionet e tjera?Nuk ka diskutime.Kryetari hedh në votim projekt-vendimin për krijimin e komisioneve të përherëshme të këshillit me ndryshimin e propozuar nga grupi Bashkë Fitojmë dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro.

6.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2023.

Dhurata-cilat janë kriteret e përcaktuara të personave për marrjen e ndihmës ekonomike?Pse familjet nuk marrin të njëjtën shumë?P/Shërbimit Social Sidorela sqaron kriteret që duhet të plotësojnë familjet,sqaron një e nga një kriteret ligjore.Kriteret janë me ligj dhe miratohen cdo vit në fillim të vitit.Masa e pagesës varet nga asetet që çdo familje ka.Dhurata-nëse një familjeje i ka vdekur bashkëshorti dhe nëna punon në administratë me pagë minimale,mund të përfitojë?Sidorela sqaron se të drejtën për të aplikuar e kanë të gjithë,dhe përzgjedhjet bëhen nga sistemi.Nëse ska marr pikët e mjaftueshme,përfiton nga 6%.Elmazi-këto familje nuk kanë dal përfituese nga skema?Sa janë si këto familje?A ka ndonjë vendim qeverie për shtim të pagesës?Sidorela-akoma nuk ka një vendim të tillë.Familjet që nuk kanë dal fituese nga skema ne i kemi futur në 6%.Dhurata-cili është përgjegjës për shpërndarjen e lekëve të kempeve dhe ndihmës,sepse kam ankesa për vonesa të pagesave.Sidorela-është përgjegjësia e postës,unë do e ngre si problem por nuk është kompetenca jonë.Kryetari-është detyra jonë të sjellim shqetësimet e komunitetit,por kjo që sapo diskutuam nuk i takon vendimmarrjes së këshillit,por mendoj se specialistja që ne kemi këtu do ta mbaj shënim dhe do ta ndjeki këtë problem.Leksi-ne kemi një pikë në fund të rendit të ditës ku mund të ngrejme shqetësimet e komunitetit,kjo pjesë nuk na takon ne si këshill.Nuk ka më diskutime.Kryetari hedh në votim projekt-vendimin e fondit të kushtëzuar 6% për muajin Maj 2023 dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro.

7.Për caktimin e vendqëndrimit provizor të shitësve ambulant në qytetin e Roskovecit.

Dr.Urbanistikes Eneida sqaron projekt-vendimin.Pasi është vërejtur se ka shumë shitës gjatë ditëve të javës dhe të shpërndarë në të gjithë zonën,si dhe shkaktojnë shumë mbeturina,është menduar që tu sigurojmë një vend të caktuar provizor,dhe ata e kanë për detyrë ta pastrojnë vet ambientin.Kryetari-ky propozim ka ardhur si pasojë e cilit shqetësim që kanë sjellë këta shitës ambulant?Kush është arsyeja që ne duhet ta kalojmë?Maksi-duke pasur parasysh shqetësimet që janë zënë trotuaret nga shitësit ambulant dhe bllokohet qarkullimi i kalimtarëve,kemi menduar që këta shitës ambulant ti grumbullojmë në një vend të caktuar,dhe vendi do të vijëzohet.Pegiola-a janë krijuar kushtet e përshtatshme për këta shitës ambulant?Maksi-po të ishin me kushte të përshtatshme do të quhej treg,por ai është një vend provizor.Amarildo-po me tregtarët ambulant jeni konsultuar?Si mund të jenë ata konkurent me njeri-tjetrin?Duke i grumbulluar në një vend mendoni se do i krijoni të ardhura?Maksi-problemi qëndron tek disiplinimi dhe vënia e rregullit në trotuare,lënie të lirë të tregtarëve vend e pa vend nuk do të ketë më.Amarildo-plotesisht dakort,por ne shohim dhe dyqane që nxjerrin fruta-perime jashtë dhe bllokojnë trotuaret,kjo është selektive.Eneida-të gjithë tregtarët që kanë nxjerr tezga jashtë dyqanit taksohen në bazë të m<sup>2</sup> që zënë,nuk është selektive,por për të gjithë është njëlloj.Leksi-ku është konkretisht ky vend?Ju thoni provizore,a ka një projekt bashkia që këta të vendosen në kushte më të mira?Maksi-sa i përket pyetjes së dytë që ngriti Leksi,ka të bëj me projektin e fushës së sportit,aty do të jetë i përqëndruar tregu,rreth e rrotull fushës.Eneida-harta është shumë e qartë,është afër Raiffeisen Bank.Fredi-mora

takim me shitësit ambulant, shumica shisnin vetëm banane, policia bashkiake kishte vendosur edhe gjoba. Nuk jam kundër nëse ne u krijojmë një treg me kushte, por më duket absurde ti marrësh 10 shitës ambulant ti çojmë përballë tek banka, sepse asnjë nuk do shesi. Shitësit e fruta-perime zënë më shumë trotuar, kjo i bie të jetë selektive. Elmazi-a ka ardhur koha që ne ti disiplinojmë tregtarët, dhe tu krijojmë kushte ku ata të shesin? Unë mendoj që po. Nuk jam dakort me selektiv, të jenë të gjithë të barabartë para ligjit, bashkia duhet ta shikoj me seriozitet këtë punë. Kryetari-sipas opinionit tim ky projekt-vendim duhet të plotësohet akoma. Këta shitës çfarë statusi kanë në lidhje me taksat e bashkisë? Duke marr pjesë në këtë treg të organizuar, a quhen më shitës ambulant? Për këtë arsye mendoj se ka vend për tu plotësuar ky projekt-vendim. Eneida sqaron projektin e Bllokut Nr.1 dhe të tregut ushqimor. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit dhe miratohet me 11 vota pro, 1 votë abstenim A. Plaka, 7 vota kundër grupi Bashkë Fitojmë. Miratohet.

8. Për eliminimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimin e banesës me kosto të ulët (objekti social 6-katësh).

Eneida sqaron projektin. Siç ndodh në të gjitha marrëveshjet që Enti ka miratuar, me vendim i shmangen taksës së ndikimit në infrastrukturë. Kjo është në bazë të marrëveshjes që Enti ka lidhur me bashkinë, e cila propozon që kjo shmangie takse të bëhet me anë të vendimit të këshillit të bashkisë. Leksi-ne kemi kaluar disa vendime me Entin e Banesave, mund të quhet i fundit ky vendim dhe të fillojë ndërtimi i pallatit sepse edhe qytetarët po lodhen dhe janë mosbesues. Eneida-sqaron se jemi në fazën e procedurës së lejes, kjo është një nga fazat e lejes e cila kërkon pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë ose shmangien e saj. Me daljen e lejes ka të drejtë të fillojë direkt punën. Jorgo-kjo taksë si do përfitohet, bashkia si do ta përfitojë, është menduar të investohet në ndonjë vend apo do i ngelet bashkisë? Kryetari-situata është e tillë : çdo ndërtim që bëhet në territorin e bashkisë, bashkia ka të drejtë të marrë taksën e ndikimit në infrastrukturë. Në rastin e banesës sociale kjo është taksë që do e vjeli bashkia, dhe do e paguaj prapë bashkia. Pra votimi ynë sot është më shumë procedural sesa për të vendosur ku do shkojë kjo taksë. Nuk kemi vjelje të vërtetë të ardhurash. Jorgo-në projekt është llogaritur kjo taksë? Kryetari-kjo taksë është vendosur siç vendoset në çdo leje, nuk kemi të bëjmë me subjekt jashtë bashkisë, por i bie ta marrë bashkia nga bashkia, është shumë e thjeshtë. Eneida-projekti ka ardhur nga Enti dhe bashkia vazhdon me procedurën e nxjerrjes së lejes. Jorgo-kostoja e këtij ndërtimi ka dalë? Maksim-nuk është e planifikuar në buxhetin e vitit 2023 as në 2024, jemi në palë e interesuar dhe fituese e këtij projekti, i bie ti nxjerrim nga njëri xhep dhe ti fusim në xhepin tjetër. Jorgo-kur nuk është e planifikuar pse duhet ta heqim? Kryetari-sepse është e detyrueshme për marrjen e lejes së ndërtimit. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro.

9. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2022.

Dr. Financës i uron suksese këshilltarëve. Sqaron se sot ne do kalojmë disa projekte të rëndësishme financiare. Shkurtimisht shpjegon se miratimi i buxhetit 3-vjeçar dhe atij vjetor ecën në disa hapa, që nga miratimi i kalendarit buxhetor në fund të vitit, dhe deri në 25 Dhjetor të vitit pasardhës ku miratohet buxheti vjetor dhe ai afatmesëm. Tani jemi në hapin e miratimit të dokumentit të I-rë të PBA-së, pastaj dokumenti i II-të që bëhet në Shtator duke marrë kërkesat shitesë, dhe përmbyllet në Dhjetor. Konkretisht për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2022, kemi bërë rekordim me degën e Thesarit për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që ka patur bashkia për vitin 2022, kemi dorëzuar bilancet të miratuara nga Thesari dhe Ministria, dhe kërkojmë miratimin e raportit vjetor të konsoliduar bazuar në këto dokumenta që ju thashë më sipër. Dhuratat tek pika e menaxhimit të mbetjeve urbane planifikuar për vitin 2022, çfarë ishte parashikuar dhe

pse investimi është zero?Selmani-tek menaxhimi i mbetjeve urbane sa investime janë planifikuar aq janë investuar.Jorgo-këto mbetje venë në icenerator apo përpunohen nga bashkia?Selmani-ky investim është kryer me financim nga Ambasada Japoneze,për blerjen e një kontinieri të madh.Maksi-të gjitha mbetjet urbane të bashkisë Roskovec nga data 1 Janar 2023 venë në icenerator,është mbyllur pika e grumbullimit të plehrave në Marinëz dhe po rehabilitohet me pemë.Ne përpunojmë mbetjet bimore në pikën e kompostimit në Marinëz fal dhe investimit të Giz,ku mbetjet bimore kthehen në pleh organik.Dhurata-për cilat mbetje bimore e keni fjalën?sepse në zonën poshtë fermerët po i hedhin në lum.Maksi-kemi bërë dëgjesa publike me banorët që ata ti nxjerrin sipas grafikut që kemi vendosur,por jo të gjithë janë disiplinuar.E rëndësishme është që puna ka filluar.Kryetari-sot e more këtë informacion,duhet ta shfrytëzosh si shërbim,madje të ftosh edhe qytetarët ta përdorin si shërbim.Melsi-faqja 11 pika 41 shpenzime periudha të ardhëshme,kujt ja keni dhënë dhe për çfarë është përdorur kjo shumë?Selmani-ka të bëj me shlyerje të detyrimeve të prapambetura,ka lindur një detyrim dhe do shlyhet në një periudhë të mëvonëshme.Melsi-çfarë është kryer me këtë shumë lekësh?Selmani-janë investime me objekte,nëse e do si informacion mund ta përgatis për herën tjetër.Melsi-tek e njëjta faqe pika 53 mjete transporti,i bie është bërë 2-fishi i blerjes për makineri nga 2021 në 2022.Selmani-përveç mjetit që u thashë,kemi marr edhe mjete falas nga projekti Giz,kemi blerë mjete për qendrën e kompostimit.Maksi-të gjitha mjetet që falen futen në llogari.Melsi-tek e njëjta faqe pika 64,këto janë investime në infrastrukturë?Nëse nuk ke informacionin e duhur mbaje shënim dhe silli mbledhjen tjetër.Selmani-kjo llogari përfshin të gjitha investimet që ne i kryejmë,janë në proces dhe nuk janë marr në dorëzim.Rritja ka ardhur kryesisht nga ndërtimi i ujësjellësit në Njësinë Administrative Strum.Melsi-faqja 15 pika 47 të ardhura jotatimore.Selmani-ky material është bërë në bazë të rakordimit me degën e thesarit,sqaron kush futet tek të ardhurat jotatimore.Melsi-faqja 16 pika 77 paga personeli i përkohshëm,sa punonjës kanë qënë,për çfarë kohe bëhet fjalë?Selmani-kanë qënë 4 punonjës,bëhet fjalë për vitin 2022.Melsi-po tek e njëjta faqe pika 85 materjale zyre,ka një rritje mbi 60% nga 2021 në 2022.Selmani-duhet të hap tabelat analitike dhe jam i gatshëm tju sqaroj.Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materialit dhe miratohet me 12 vota pro,7 kundër nga grupi Bashkë Fitojmë.Miratohet.

10.Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2024-2026.

Maksi-meqë është buxheti afatmesëm 2024-2026,sot ju kërkoj ta kalojmë në parim,dhe buxhetet vjetore do i diskutoni dhe konsultoni çdo vit.Ky është një detyrim ligjor.Kryetari-keni shumë të drejtë kur thoni që doni kohë,por kërkoj bashkëpunimin tuaj për ta kaluar për arsye të afateve kohore,sepse është faza e parë,do keni kohë në fazat e tjera për ti diskutuar më tepër.Kryetari kërkon sqarim nga Selmani për projekt-vendimin.Selmini-sqaron se kjo është faza e parë e përgatitjes së dokumentit të parë të PBA 2024-2026,kemi zhvilluar dhe dëgjesat publike në muajin Maj.Sqaron të gjitha hapat që janë ndjekur për realizimin e këtij dokumenti,sipas hapave ligjor.Miratimi i PBA 2024-2026 fillon në 1 Janar dhe përfundon në 25 Dhjetor me miratimin e buxhetit të vitit të parë të PBA.Jorgo-ky dokument është voluminoz,na jepni kohë që ta shikojmë.Kryetari-nuk do ndryshojë asgjë ky fakt,nëse ky dokument miratohet sot apo në mbledhjen e ardhëshme.Deri në Dhjetor do kalosh 3 hapa,nëse e kalojmë sot apo në mbledhjen tjetër nuk do ndryshojë gjë,vetëm se sdo zbatohen afatet ligjore.Ju ftoj për procedurë ta kalojmë sot këtë program,nuk dëshiroj të bëhemi shkak i shkeljes së afateve ligjore,për një gjë që nuk do sjelli asnjë ndryshim.Fredi-ju po thoni ta votojmë pa e lexuar,pa e konsultuar?Kryetari-ju e keni pasur materialin,që të paktën ta kuptoni në thelb me çfarë keni të bëni,kemi patur të gjithë bashkë

kohën e mjaftueshme.Fredi-unë të kam kërkuar ta lëm për mbledhjen tjetër,që të konsultohem.Kryetari-në vijim të diskutimit që kemi bërë bashkë,informacioni që kam marr është në këtë arsyetim që sapo thashë,nuk do ndryshojë asgjë ai fakt.Koha ka qënë e mjaftueshme.Elmazi-jam dakort me shumicën e këshilltarëve,është e vërtetë që të gjithë ne nuk jemi specialist të kësaj fushe.Grupet nuk janë mbledhur dhe nuk kanë diskutuar,nëse grupet do mblidheshin do thërrisnim specialistin ta dëgjonim për çdo zë.Unë mendoj ta kalojmë në parim,dhe grupet e punës të mblidhen,të diskutojnë dhe në mbledhjen tjetër të ngrenë shqetësimet që kanë.Kryetari-duhet që të gjithë të angazhohemi,që në dy muajt e ardhshëm të marim sa më shumë informacion nga specialistet,mblidhemi komisionet dhe grupet për ta parë me hollësi.Të drejtën e kësaj vote sot do e kemi edhe 2 herë të tjera.Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit dhe miratohet me 12 vota pro,7 vota kundër të Bashkë Fitojmë.Miratohet me shumicë votash.

11.Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023.

Dr.Financës sqaron projektin,i cili ka të bëj me fondin e grandit të akorduar nga Ministria e Financave,të fondeve për rritjen e pagave të arsimit parashkollor (edukatore),zjarrfiksjat dhe ujitja e kullimi.Është dërguar fondi në formën e grandit specifik të pakushtëzuar,i cili do të ndahet për paga dhe sigurime shoqërore vetëm për këto funksione.Fondet i kemi të përcaktuara,të ndara sipas nevojave që kemi.Dhurata-të lutem mi sqaro edhe njëherë tabelat se jam pak e paqartë,atje ku thotë arsimit parashkollor?Selmani sqaron se ka të bëj vetëm me shtesën e pagesës që marrin bruto si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.Maksi-pagesa për arsimin parashkollor,zjarrfikset,ujitja dhe kullimi me vendim qeverie është rritur,dhe fondi i këtyre pagave miratohet nga ju sot në buxhetin e bashkisë.Selmani sqaron se ka filluar rritja,edukatoret kanë marr që nga muaji Prill.Kryetari pyet nëse ka më diskutime.Nuk ka.Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit dhe miratohet me 17 vota pro,2 vota kundër Melsi,Amarildo.Miratohet me shumicë votash.

12.Raport i monitorimit për 4-mujorin e I viti 2023.

Dr.Financës sqaron raportin e monitorimit.Ky është raport për 4-mujorin e parë për vitin 2023,i cili do të pasohet me raport për çdo 4 muaj,dhe në fund do të bëhet raport i konsoliduar për vitin 2023.Pra kemi dhe 2 raporte të tjera përveç këtij,i kemi të përcaktuara të gjitha sipas programeve në tabela,kemi dhe një tabelë të realizimit të investimeve,sa ishin të mbartura nga viti i kaluar,sa janë realizuar,sa janë likujduar dhe sa kanë ngelur pa u likujduar.Nuk ka diskutime për këtë informacion.

13.Për miratim të përdorimit të fondit rezervë për vitin 2023.

Selmani-sqaron projektin,për ti ardhur në ndihmë shkollave për ti përmirësuar sado pak kushtet,ju kemi sjellë këtë projekt dhe preventiv,ku për vitin 2023 të përdoret pjesa e mbetur e fondit rezervë dhe pjesa tjetër të financohet për vitin 2024.Dhurata-unë e pashë pak materjalin,dhe vura re që mungojnë shkollat vartëse.Është thënë që shkollat vartëse nuk do ekzistojnë më.Së pari unë uroj që të kthehemi së bashku me nxënësit tek ajo shkollë në Shtator,e dyta çfarë do të ndodh me shkollat vartëse?Maksi-sa i përket këtij problemi,ka të bëj me një dëgjese publike që bëhet me komunitetin e prindërve,komunitetin e shkollës,këshillin pedagogjik dhe me nxënësit,për shkollat vartëse,atje ku nuk plotësohet numri i nxënësve.Ne jemi munduar të zbatojmë ligjin,por gjithmonë duke marr edhe konsensusin e komunitetit.Tani jemi në fazën e diskutimit.Synimi dhe qëllimi ynë nuk është për mbylljen e tyre, për arsye sociale.Dhurata-unë flas në emër të komunitetit dhe kjo është gjëja më e drejtë,por nëse do lihen akoma ekzistuese ato janë gati 50-60% të amortizuara,shkolla në Agaçaj ka nevojë për çati.Maksi-fal projektit të Ministrisë së Arsimit dhe qeverisë shqiptare,shkollat e zonës tonë,pothuajse janë rikonstruktuar të gjitha,kemi problematik Vidhishtën

dhe Luarin. Dhurata-duhet të presim një përgjigje për shkollat vartëse Arapaj dhe Agaçaj ?Maksi-jemi në diskutim sipas ligjit. Kryetari-faleminderit Dhurata për shqetësimin që solle, edhe pse nuk ishte në temën e këtij projekt-vendimi, por është një shqetësim i qenësishëm. Amarildo-dëgjova nënkryetarin që përmendi shkollën Vidhishtë, nuk e di nëse do e çonte fëmijën e tij aty, sepse di që në Vidhishtë mungon uji, banjot nuk ekzistojnë fare, çatia pikon, nuk ka ngrohje, nuk ka priza. Maksi-për problemin e energjisë elektrike, jemi munduar të rrisim fuqinë, banjo dhe ujë ka. Kryetari-mesa shikoj në preventiv, shoh që tek shkolla Ali Sollaku janë parashikuar instalimi i sistemit 3 fazor të energjisë, riparime dyersh, grupe lavamani, kaseta banjo, mekanizma për shkarkim. Amarildo-për çatinë nuk është parashikuar. Maksi-çatia është investim. Elmazi-nëse atje është si në mesjetë, aparati i bashkisë duhet ta verifikojë dhe në mbledhjen tjetër të sjelli informacion. Nëse atje pikon lër të bëhet një investim, se u bëhet nxënësve tanë, ne nuk kemi ngjyra në këshill, duam vetëm tu vijmë në ndihmë komunitetit. Kryetari-të mbahen shënime propozimet e këshilltarit. Fredi-nëse është mundësia dhe ka një fond ta miratojmë bashkë me këtë. Maksi-për çatin mund ta marrim me investim të Ministrisë së Arsimit siç bëmë me Kurjanin. Ermira-që të mos ndodhemi përsëri në të njëjtën situatë, në buxhetin për vitin tjetër, të shënohet një zë i veçantë, pasi të studiohet në fund të vitit shkollor se çfarë nevojash emergjente kanë shkollat, të vendoset një fond i caktuar si pikë e veçantë. Është sugjerim më tepër që të mos gjendemi përsëri në të njëjtën situatë. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas mterjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro.

14. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Fredi-në emër të transparencës, propozoj që mbledhjet e këshillit të transmetohen live me monitor jashtë. Kryetari-propozimi do mbahet shënime, por dua tju kujtoj që mbledhjet e këshillit janë të hapura, ka një vend të caktuar për të gjithë qytetarët që duan ta ndjekin mbledhjen, nëse ambientet në sallë do ishin ezauruar, do ta gjeja me shumë vend, por gjithsesi kjo qëndron. Maksi-disa mbledhje i kemi transmetuar edhe live. Nuk ka më diskutime. Kryetari i falenderon dhe mbyll mbledhjen.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**

**Kryetar**

**Afrim Plaka**